



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2024:004287

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05528068

PPP.nr.2/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja Pajtesë Boshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektirkie Sh.a, me adresë në Bulevardi “Bill Klinton”, në Prishtinë, ndaj debitorës A.H nga fshati B., Komuna I., nga baza juridike përmbarimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorës A.H të datës 28.12.2023, të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.424/2023 i datës 18.12.2023, jashtë seancës gjyqësore, me datë 29.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET I PABAZUAR prapësimi i debitorës A.H i datës 28.12.2023, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.424/2023.

A r s y e t i m

Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektirkie Sh.a ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit ndaj debitorës A.H, në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me energji elektrike për periudhën kohore nga data 21.01.2023 deri me datën 04.11.2023, baza juridike borxh në vlerë prej 500.88 €.

Përmbaruesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit me Urdhrin P.nr.424/2023 të datës 18.12.2023, ka lejuar përmbarimin e propozuar.

Kundër këtij aktvendimi, debitorja në afatin e lejuar ligjor, me datë 28.12.2023 ka paraqitur prapësim, duke theksuar se përmbaruesi ka lejuar gabimisht përmbarimin ndaj debitorit pasi që përsone i autorizuar për të vërtetuar saktësinë e kopjes së dokumentit të besueshëm është noteri dhe kopja e tillë nuk është e vërtetuar. Më tej debitorja ka shtuar se, e kundërshton shumën e kërkuar me urdhër për përmbarim për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, për shkak se jeton vetëm nga pensioni i verbërisë dhe me këtë shumë të të hollave i duhet të mbajë familjen, duke i propozuar gjykatëse ta provoj prapësimin dhe të anulohet urdhëri për përmbarim.

Përfaqësuesi i kreditorit në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka propozuar që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka konstatuar se të njëjtat nuk janë të bazuara dhe nuk përmbajnë asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, në bazë të të cilave shkaqet gjykata duhet ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Neni 29 paragrafi 1 i LPP-së, shprehimisht përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është, Pika 1.2 “ ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave ”* ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”,* prandaj në rastin konkret gjykata vlerëson se dokumenti përmbarimor në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, përkatësisht ekstrakti nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të ujit, energjisë elektrike dhe hedhurinave është i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata pretendimin e debitorit se nuk ka mundësi të paguaj borxhin për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, nga shaku se jeton vetëm nga pensioni i verbërisë dhe me këtë shumë të të hollave i duhet të mbajë familjen, ashtu siç parashihet në nenin 112 paragrafi 1 të LPP-së, ku shprehimisht përcaktohet se: *“Përmbarimi në të ardhurat personale, për shpërblimin në vend të pagës dhe për pensionin, mund të caktohet dhe zbatohet deri në gjysmën e lartësisë së tyre. Shuma që sekuestrohet do të kufizohet në pjesën që tejkalon shumën e ndihmës më të lartë sociale që paguhet brenda territorit ku debitori ka vendbanimin”.* Ndërsa, sa i përket lartësisë së

pensionit, organi përmbarues do t'i përmbahet kufizimeve të parapara me LPP, me rastin e ekzekutimit të vendimit.

Më tej, debitorja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi me të cilën vërtetohet se është përmbushur detyrimi sipas dokumentit përmbarimor e duke u bazuar ne dispozitën ligjore të nenit 69 paragrafi 4 të LPP-së i cili shprehimisht përcakton se: *baza për prapësim duhet te mbështetet me prova te duhura, provat për prapësim duhet te dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do te refuzohet.*

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjatimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.*

Nga arsyet e theksuara me lartë, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
PPP.nr.2/24, datë 29.03.2024

Gj y q t a r j a

Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.